

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

FTOJ

Mbledhjen e pestë të Kuvendit komunal e cila do të mbahet më: **31.05.2024** (E premte) duke filluar në ora **10:00**.


Rendi i ditës

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Informat mbi qarkoren e parë Buxhetore të Ministrisë së Financave;
3. Bartja e mjeteve të investimeve kapitale;
4. Raportim nga Drejtoria e Bujqësisë rreth mbjelljeve pranverore;
5. Planifikimi dhe mbajtja e takimeve të Kuvendit me qytetarët e Komunës së Novobërdës për propozim buxhetin e vitit 2025/27;
6. Të ndryshme;

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më: 23.05.2024
Në: Novobërdë

Kryesuese e Kuvendit
Mirjana Simijonović



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Procesverbali i Kuvendit

Nga mbledhja e katërt e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 30.04.2024, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj. Mirjana Simijonovic, zv. kryesuesi i kuvendit zt. Ramush Mehmeti, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhju, Dobrivoje Djordjevic, Abdyl Gashi, Vlora Vllasaliu, Stefan Kovacevic, Violeta Milosevic, Dragana Dimic, Ivica Cenic, Drejtori i Financave Milos Denic, Menaxheri i kompanisë Ekologjia, përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit pasi pershendeti të pranishmit tha: konstatoj korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

Rendite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Raporti Financiar i tremujorit të parë Janar - Mars 2024;
3. Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2023 në vitin 2024;
4. Raportimi i Kompanisë Ekologjia për punët e kryera nga Kompania Ekologjia në terren;
5. Aprovimi i memorandumit të bashkëpunimit në mesë të Komunës së Novobërdës dhe Kompanisë „Titan“;
6. Të ndryshme;

Kryesuesja tha: pasi që për piken e pestë nuk kemi material, d.m.th. ende nuk është pregaditur memorandumimi në bashkëpunim me Kryetarin kemi vendosur që ta tërhejm këtë pikë dhe ta shtyem për një nga mbledhjet e radhes kur të jetë gati memorandumimi.

Aprovohet njëzëri që pika e pestë të tërhiqet nga rendi i ditës.

Kryesuesja i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend të ditës?.

Pasi nuk pati propozime shtesë rendi i ditës u aprovua njëzëri nga antarët prezent pa piken e pestë.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali u aprovua njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Raporti Financiar i tremujorit të parë Janar - Mars 2024;

Kryesuesja për këtë pikë ja kaloi fjalën Drejtorit të Financave.

Procesverbali i Kuvendit

Milos Denic pasi pershendeti të pranishmit tha: po besoj që materialin e keni marrë me kohë, po fillojmë prej të hyrave gjithësej për këtë tremujor i kemi 102,237.11€, ku bëjnë pjesë të gjitha të hyrat duke filluar nga të hyrat nga tatimi në pronë 46,946.26€, nga regjistrimi i automjeteve 3,730.00€, taksat për vertetim 62.00€, taksat Komunale për leje ndertimore 301.44€, Taksat komunale për regjistrimi i trashigimis 60.00€ taksat për ndrrimin e destinacionit të tokës 34,781.21€, taksë për regjistrim të hipotekës 120.00€, taksa tjera administrative-lista poseduese 3,982.00€, perdorimi i pronës publike 2,000.00€ e të hyrat e tjera i keni të paraqitura në tabel, më pastaj i kemi shpenzimet për çdo kategori të ndarë në tabela për secilen Drejtori veç e veç.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: është mirë që së paku kur të jetë raporti financiar të jenë edhe drejtorat prezent pasi që ka të bëjë me shpenzimet për secilen drejtori pasi që ndoshta e ka të pamundur Drejtori i Financave të na jep informata për shpenzimet në drejtori të tjera. Te zyrja e Kryetarit janë shpenzuar për dreka zyrtare 3,637.89€, mirëmbajtja rutinore 33,305.21€ edhe kjo është e paqartë dhe kerkoj sqarim nga drejtori, poashtu te sherbimet rezidenciale janë shpenzuar mbi 3,000€ dreka dhe te sektori i barazis gjinore është një shumë 1,800€ për dreka zyrtare dhe mendoj se këto shuma kishte qenë më mirë të ishin ndonjë projekt që e kishin shfrytëzuar të gjithë qytetarët. Edhe të mirëmbajtja e makinave ka shpenzime të panevojshme ndërsa se dim se sa makina ka Komuna jonë, kerkoj një sqarim nga Drejtori.

Kryesuesja tha: ju e din se administrata e Kuvendit ja u dergon të gjithëve ftesat e Kuvendit dhe është në vullnetin e tyre nese vin apo jo.

Pasi nuk pati diskutime me 14 vota për 1 apstenim aprovohet nga antarët prezent të Kuvendit pika e dytë dhe mirret ky:

VENDIM

APROVOHET raporti financiar i Komunës së Novobërdës për tremujorin e parë Janar – Mars 2024.

Pika e tretë: Bartja e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2023 në vitin 2024;

Kryesuesja për këtë pikë ja kaloi fjalën Drejtorit të Financave.

Milos Denic tha: janë mjete nga viti i kaluar 2023 që i kemi të pashpenzuara në shumë totale prej 193,396.87€ që do të barten për këtë vit 2024. e kam derguar këtë raport, ndërsa sot e keni marrë edhe tabelen se ku do të barten. Këto mjete janë bartur në mënyrë automatike sipas tabelës që e keni marrë me material.

Ndërsa shumë prej 43,000€ do të barten në subvencione në zyrën e Kryetarit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Stojan Stanojevic tha: subvencionet prej 38,000€ a mundë të jen subvencione në bujqësi që t'ju mundësojnë njerëzve që punojnë me bujqësi ti ndihmojnë me subvencione. Edhe pse në vitin 2023 ka pasur projekte por kemi nevoj ende që disa rrugë të sanohen andaj kerkoj që të asfaltohen disa rrugë dhe kerkoj që këto mjete të barten për investime kapitale në projekte.....

Abdyl Gashi tha: drejtori dha informata më të zgjeruara, e dim se Komuna i ka perfitu prej Ministrisë së Infrastruktues 500,000€, por drejtori duhet ta ketë një planë më të detajuar se ku do të shpenzohen këto mjete sidomos të subvencionimi, të ketë subvencione edhe në arsim të përfitojnë studentat e dalluar.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 14vota për, 1 përmbajtur aprovohet nga antarët prezent të Kuvendit kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Me këtë vendim barten mjetet financiare nga të hyrat vetanake në shumë prej: 193.396.87 € të vitit 2023 në vitin 2024

material.

Ndërsa shumë prej 43,000€ do të barten në subvencione në zyrën e Kryetarit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Stojan Stanojevic tha: subvencionet prej 38,000€ a mundë të jen subvencione në bujqësi që t'ju mundësojnë njerëzve që punojnë me bujqësi ti ndihmojnë me subvencione. Edhe pse në vitin 2023 ka pasur projekte por kemi nevoj ende që disa rrugë të sanohen andaj kerkoj që të asfaltohen disa rrugë dhe kerkoj që këto mjete të barten për investime kapitale në projekte.....

Abdyl Gashi tha: drejtori dha informata më të zgjeruara, e dim se Komuna i ka perfitu prej Ministrisë së Infrastruktues 500,000€, por drejtori duhet ta ketë një planë më të detajuar se ku do të shpenzohen këto mjete sidomos të subvencionimi, të ketë subvencione edhe në arsim të përfitojnë studentat e dalluar.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 14vota për, 1 përmbajtur aprovohet nga antarët prezent të Kuvendit kjo

Pika e katërt: Raportimi i Kompanisë Ekologjia për punët e kryera nga Kompania Ekologjia në terren; Kryesuesja për këtë pikë ja kaloi fjalën menaxherit të Ekologjis Naser Ibrahimit.

Naser Ibrahimit pasi pershendeti të pranishmit tha: ju e dini se Kompania jonë funksionon prej vitit 2010, vitin e fundit kemi kaluar me Ekologjin ku aty i kemi marrë edhe disa punëtorë. E kemi pasqyren e tremujorit për mirëmbajtjen e mbeturinave në terren dhe aty i kemi edhe shpenzimet e karburanteve.

Kërkesa jonë e vetem është sigurimi i një veture, gjithashtu kemi kërkesa ende për kontinjera, se paku edhe 500 kanta që me mbulu të gjithë teritorin.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Stojan Stojanovic tha: unë shpesh kam kërkuar që ai automjete të sigurohet pasi që është i nevojshem, e falenderoj Kompanin për punën që po e bëjnë, rrugët po pastrohen dhe po grumbullohen mbeturinat.

Dobrivoje Djordjevic tha: disa puntorë po i shoh që po i mbledhin mbeturinat dhe po i fusin në thasë a janë puntorë të Komunës apo të Ekologjisë.

Naser Ibrahimit tha: 25 puntorë janë nga Komuna por ne jemi në bashkëpunim me ta.

Selatin Nuhiu pasi pershendeti të pranishmit tha: unë e kam një kërkes nga Ekologjia që në fshatrat pak më të mëdha të vendosen kontinjera publik. Edhe ju pasi po kerkon një vetur por unë nuk e di se kjo kompani a është publike apo private, nese është publike kjo Kompani duhet ta ketë edhe bordin ku i bënë politikat e veta të Kompanisë, andaj me intereson se a ka bord dhe a kemi ne perfaqësues.

Naser Ibrahimit tha: ne kemi vendosur disa herë kontinjer publik sidomos në Stanishor por perseri qytetarët nuk i kan hudh aty por në tokë. Sa i perket bordit është e vertet se kompania është e regjistruar në atk dhe e ka bordin e vet mirëpo neve nuk na kanë njoftu asgjë asnjëher, pasi që në Gjilan nuk kemi pasur marrëveshje afatgjatë por kemi pasur marrëveshje të shkurtë. Ndërsa sa i perket automjeteve Komuna e Graçanices ju ka dhënë 4 automjete dhe beseoj se edhe neve ka mundësi për një automjet.

Abdyl Gashi tha: pak është shqetësuese se si funksionon kjo Kompani, njëher aplikoj me çmim me të lirë, pastaj e rriti çmimin ndoshta kishte qenë më mirë që Komuna ta ketë Kompaninë e vetë, e jo të veproj një kompani komplet private ndërsa shpenzimet tja mbuloj Komuna, duhet të jetë e kunderta Kompania duhet me i dhënë raport Komunës e jo Komuna me ja kry sherbimet Kompanisë private.

Kryesuesja tha: e diem se jemi Komunë evogel me teritor të madhë, nuk kemi përfaqësues as në Ekohigjen e as në Hidromorav edhe pse kemi pasur memorandum të bashkëpunimit. Sa i perket Kompanisë ne po shohim një permirësim të madhë, nuk kemi deponim, po kositin po mirëmbajn rrugët e po i pastrojn mbeturinat. Ne puntort i kemi për rrugë, një herë në javë po i mirëmbajnë rrugët.

Naser Ibrahimit tha: është e vertet që Komuna jonë duhet ta ketë kompanin e pavarur por ne nuk mundë të ekzistojm si kompani e pavarur me këto të hyra që i kemi. Ne çdo vend jemi të perpiktë dhe jemi tu i kyç, vetem disa fshatra të vogla nuk i kemi në sistem.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: unë i përgezoj Kompanin për punen që po e bënë dhe është e vertet se ka përmirësime të mira. Sa i perket pyetjes për bord kjo kompani është publiko-private dhe nese komuna participon deri në 40% ka të drejt të ketë antarë të bordit, në këtë rast ne nuk jemi partnerë, komuna ka vetem memorandum bashkpunimi dhe kjo kompani vetem na ofron sherbime. Por sikur të kishte interesim nga njerzit ku do të participonte edhe Komuna do të kishim edhe kompanin nga Komuna jonë.

Abdyl Gashi tha: kompania kur ka aplikuar në tenderim është dashurt të shikoj se sa është numri i baorëve dhe sa është teritori i madhë e jo më pastaj të thot se spo kemi llogari me atë çmim e po e rrisim çmimin, besoj se kriteret ceken në çdo tenderim.

Procesverbali i Kuvendit

Ramush Mehmeti tha: besoj se jam i qartë, marrëveshja që ka qenë njëvjeçare ashtu ka funksionuar si ka aplikuar kompania me çmim 4€, por ne po e shohim gjendjen në terren dhe kompania ka bërë kërkesë për me vazhdu marrëveshjen me kerkesat e veta.

Pika e pestë: të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Stojan Sanojevic tha: pse makinat bujqësore ende nuk janë shpernda, drejtori ka thënë se ka ankesa, është komisioni nese nuk e kryen punen e vet të ndrrohet komisioni dhe të shqyrtohen ato ankesa nga komisioni pasi që kjo është jo seriozitet shumë i madhë.

Abdyl Gashi tha: po e ngris një shqetësim aty ku e di në fshatin Llabjan në një lagje sa i perket transportit të nxenësve me i marrë i marrin por nuk i kthejn në shtepi, nuk e di ndoshta ka edhe në lagje e fshatra tjerë por nuk jam i informuar, andaj kerkoj nga Drejtoria e Arsimit që të jenë më të përgjegjshëm sa i perket transportit në atë lagje.

Kryesuesja tha: do ti percjellim kërkesat tuaja.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00.

Ramush Mehmeti tha: besoj se jam i qartë, marrëveshja që ka qenë njëvjeçare ashtu ka funksionuar si ka aplikuar kompania me çmim 4€, por ne po e shohim gjendjen në terren dhe kompania ka bërë kërkesë për me vazhdu marrëveshjen me kerkesat e veta.

Pika e pestë: të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Stojan Sanojevic tha: pse makinat bujqësore ende nuk janë shpernda, drejtori ka thënë se ka ankesa, është komisioni nese nuk e kryen punen e vet të ndrrohet komisioni dhe të shqyrtohen ato ankesa nga komisioni pasi që kjo është jo seriozitet shumë i madhë.

Abdyl Gashi tha: po e ngris një shqetësim aty ku e di në fshatin Llabjan në një lagje sa i perket transportit të nxenësve me i marrë i marrin por nuk i kthejn në shtepi, nuk e di ndoshta ka edhe në lagje e fshatra tjerë por nuk jam i informuar, andaj kerkoj nga Drejtoria e Arsimit që të jenë më të përgjegjshëm sa i perket transportit në atë lagje.

Kryesuesja tha: do ti percjellim kërkesat tuaja.

Pasi nuk pati diskutime tjera Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:00.

Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit

Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse